

Njoftim për Mediat

20 Tetor 2015, Dita Botërore e Statistikave

INSTAT në “Ditën Botërore të Statistikave” më 20 tetor 2015, në bashkëpunim me Fakultetin Ekonomik të Tiranës organizoi aktivitetin “Dita e hapur për Statistikat”. Ky aktivitet vjen në kuadër të rezolutës së Kombeve të Bashkuara, ku data 20 tetor 2015 është shpallur si “Dita Botërore e Statistikave” me moton “Të dhëna cilësore, jetë më e mirë”.

Në fjalën e hapjes, Dekani i Fakultetit Ekonomik Prof. Fatmir Mema u shpreh se është i kënaqur me pritjen e këtij aktiviteti në ambientet e Fakultetit Ekonomik. Ai tha se statistikat janë të rëndësishme për të gjithë dhe se Fakulteti Ekonomik është kontribues në prodhimin e tyre duke ofruar ekspertë nga njëra anë por është edhe përdorues i tyre nga ana tjetër. Gjithashtu ai shtoi se bashkëpunimi me INSTAT ka qenë gjithnjë i frytshëm dhe se ka nevojë përsëri për rritjen e këtij bashkëpunimi në të ardhmen.

Me tej, fjalën e mori Drejtoresha e Statistikave Sociale në INSTAT, Znj. Emira Galanxhi ku theksoi se “Një falenderim i veçantë shkon për Fakultetin Ekonomik i cili u ofrua për të realizuar “Ditën Botërore të Statistikave” në ambientet e tij. Statistikat janë deçizive në vendimmarrjen e kujtdo. Mbi statistika ndërtohen bazat e vendimeve për të cilat na afektojnë jetën tonë çdo ditë. Pra, mbi statistika fakulteti programon se sa studentë do të ketë në një vit akademik, sa logjistikë mbështetëse duhet, sa pedagogë etj. Nga ky përdorim i thjeshtë e deri tek vendimmarrjet e politikbërësve statistikat janë vendimtare. Pra, nëse diku do të ndërtohet një shkollë, një ambulancë, një zyrë pune, një biznes apo ujësjellës etj patjetër që statistika do të duhet të ndihmojë që këto vendime të jenë marrë konform kërkesave që ka komuniteti, biznesi e të tjerë aktorë”.

Znj. Galanxhi shtoi se “INSTAT i është bashkuar kësaj iniciative mbarë botërore duke organizuar këtë event ku do të prezantojë për herë të parë dy aplikacione për t’u ardhur sa më pranë përdoruesve. Siç do ta shihni dhe vetë më vonë në prezantimet e aplikacioneve, sidomos atë të emrave, do të kuptojmë që statistikat nuk janë vetëm ato për të cilat gjithnjë debatohet apo ka kundërshti, po ato mund të jenë utilitare dhe të përmbushin edhe kërkesa specifike të përdoruesve, pse jo edhe të shuajnë kuriozitetin e tyre”.

Për publikim 20/10/2015

Më pas, fjalën e mori Z. Ervin Shameti, Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë në INSTAT. Ai lançoi aplikacionin më të ri për android “Publikime të INSTAT”. Z. Shameti theksoi se “INSTAT në bashkëpunim me Ambasadën Zvicerane mendoi që pas një suksesi të një aplikacioni në faqen e INSTAT siç ishte INSTATGIS për të dhënat e gjeoreferuara të Censusit dhe Banesave 2011, mendoi se përdoruesve, të cilët e kërkojnë informacionin jo vetëm në kohë reale por edhe me mjetet teknologjike të avancuara, do ti shërbente një aplikacion për publikimet e INSTAT në smartphone. Ndaj dhe ky aplikacion do tu vijë në ndihmë përdoruesve për të marrë në kohë reale të gjitha publikimet që prodhon INSTAT duke përdorur avantazhet që ofron një smartphone siç është që të shkarkosh publikimin direkt në kohë apo të kesh mundësinë që të regjistrohesh nëse je i interesuar në një fushë statistikore të caktuar. Ky aplikacion bashkë me atë të emrave janë në fakt në fazën e parë beta, por ne kishim dëshirën ta prezantonim sot në këtë event kuptimplotë, në Ditën Botërore të Statistikave për t’ua ofruar përdoruesve të kualifikuar, ju e kushdo tjetër që është i interesuar.”

Në fund të këtij takimi u prezantuan dhe 2 risitë më të reja të INSTAT, aplikacioni i emrave i cili gjendet lehtë në faqen zyrtare www.instat.gov.al si dhe aplikacioni “Publikime të INSTAT” i cili gjendet në Playstore të Google.

Gjatë këtij aktiviteti INSTAT nëpërmjet një stende me publikime shpërndau për studentët disa libra të INSTAT dhe një pjesë të tyre ia dhuroi Fakultetit Ekonomik.